



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 89/2024
Datë: 30 janar 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25 dhe nenit 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe nenit 32 të Rregullores Nr.05/2020 për Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve në takimin e mbajtur më datë 30 janar 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet dorëheqja e z. Ardian Hajdaraj, nga pozita e Kryesuesit të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.
- II. Ndryshohet dhe Plotësohet vendimi KPK/Nr.639/2023, i datës 31 gusht 2023 për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, ashtu që në vend të Kryesuesit Ardian Hajdaraj, Kryesues emërohet Veton Shabani, andaj, komisioni do të ketë këtë përbërje:
 1. Veton Shabani - Kryesues;
 2. Aleksandër Lumezi - Anëtar, dhe
 3. Nazan Shero - Anëtare
- III. Anëtarë rezervë të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Performancës janë:
 1. Merita Bina-Rugova - Zëvendës kryesues;
 2. Lulzim Sylejmani - Anëtar
- IV. Obligohen anëtarët e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t' i ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- V. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'i dërgohet:

- z. *Ardian Hajdaraj*;
- *Anëtarëve të Komisionit*;
- *Kryeprokurorit të PTH Ferizaj*;
- *Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve*;
- *Arkivit të KPK-së*.